



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236527

Datë: 08.08.2024

Numri i dokumentit: 06033044

AC-I-23-0150

Në ankesën e

Paditësi

S V nga Obiliqi- e përfaqësuar nga avokat B I, avokat nga Prishtina.

E paditura/Ankuesja

Kundër:

NSH " Barnatorët e Prishtinës" (në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1445, të datës 20 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 08 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Ndryshohet pika I dhe II e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1445 i datës 20 shkurt 2023 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN068-0036 i datës 25 qershor 2015.**

- 3. Aprovohet pjesërisht kërkesa e paditësit, ashtu që Obligohet e paditura AKP, që paditësit S V në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën maj 2010 -shkurt 2013, t'i paguaj shumën prej 8,203.52 euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 820.35 euro, të gjitha sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**
- 4. Pjesa tjetër e kërkesës së paditësit për pagat e papaguara për periudhën tetor 2009-prill 2010 si dhe për periudhën mars 2013- maj 2013 refuzohet si e pa bazuar.**
- 5. Vërtetohet pika III e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1445 i datës 20 shkurt 2023.**
- 6. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 28 korrik 2015, paditësi ka paraqitur ankesë në Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit (AL), me shenjën PRN068-036, me të cilin i është aprovuar pjesërisht kërkesa për kompensimin pagave në shumë prej 7,347.06 euro, për periudhën tetor 2010- shkurt 2013 nga N.SH "Barnatoret e Prishtinës" (në likuidim). Pjesa tjetër në shume prej 1,029.00 euro, ishte refuzuara për shkak se paditësit kjo shume ishte njohur me vendimin e AL PRN068-0038 në emër të tri pagave të papaguara për periudhën mars -maj 2013, ndërsa pjesa tjetër për pagat e papaguara për periudhën tetor 2009-tetor 2010, në shumë prej 943.25 euro ishte refuzuara si e përshkruara konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi me ankesë ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie punë në ndërmarrje dhe se pranë Autoriteti të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 8,969.45 €. Autoriteti i Likuidimit me vendimin e kontestuar e ka miratuar pjesërisht kërkesën për kompensim të pagave. Ka pretenduar se vendimi i lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit është përfshitë në aplikim të gabuar të dispozitave materiale juridike. Autoriteti i Likuidimit nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën e nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet ky ligj ka pushuar se vepruar, saktësisht me neni 196 i Ligjit për Ndërmarrjet është e përcaktuar se me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk do të zbatohet Ligji për Punën e

Bashkuar. I ka propozuar gjykatës që ta miratoj si të bazuar ankesën e parashtruar dhe te shfuqizohet pika tre e vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe të obligohet pala e paditur që t'ia kompensoj shumën prej 8,969.45 €, kamatën në shkallën prej 10 %, sipas nenit 37.3 të Shtojës së Ligjit për AKP-në si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 104.00 euro.

Pala paditëse, padisë ia ka bashkangjitur vendimin e atakuar të AL-së, me shenjë, PRN068-0036, të datës 25.06.2015, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 30.05.2013, një kopje të leternjoftimit të paditesit si dhe autorizimin për perfaqësim.

Me 10 shkurt 2023, e paditura ka paraqitur përgjigje në ankesë, ku ndër të tjera ka theksuar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL-së, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Sipas të paditurës, paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur. Po ashtu, përgjigja në padi i referohet nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Më tutje, ka theksuar se vendimi i AL-së, është bazuar në faktin se kërkesa kreditore është parashkruar, sipas kufizimeve kohore të aplikueshme. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar dhe te vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 20 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1445, e ka Miratuar pjesërisht si bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka ndryshuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit, me shenjë PRN068-0036, të dt.25.06.2015, dhe e ka detyruar te paditoren që t'ia paguaj paditësit shumën prej 8,686.08 €, në emër të kompensimit të pagave të papaguar për periudhën Maj 2010 – Maj 2013 (36 paga), si dhe shumën prej 868.00 €, në emër të kamatës së vonesës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë, në shumën totale për pagesë prej 9,554.08 €, e cila shumë duhet të shpërndalet tek paditësi në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

Në piken II është refuzuar pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara, respektivisht mbi

shumën e aprovuar me këtë aktgjykim. Ne piken III paditesit shkalla e para i ka njohur shpenziemt e perfaqësimit në shumën prej 124.00 €.

Shkalla e parë ka arsyetuar se në këtë çështje kontestimore, faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese. Sikurse vendimi i AL-së i atakuar me ankesë, ashtu edhe përgjigja në ankesë e paraqitur nga AKP-ja dhe parashtrimet e tjera të mëvonshme, nuk i kontestojnë faktet dhe rrethanat në të cilat thirret pala paditëse në kërkesën kreditore dhe me kërkesëpadi. Por, refuzimi i pjesëshëm i kërkesës është mbështetur vetëm në pretendimin se kërkesa kreditore është e parashkruar. Shkalla e parë kishte ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritorë (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme. Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe provat e shqyrtuara, rezulton se kontesti në mes të palëve në procedurë është i natyrës së pastër ligjore, ku pala e paditur ka pretenduar se paditësit nuk i takon kompensimi i pagave në shumën e plotë sa është kërkuar, ngase është parashkruar kërkesa për një pjesë të detyrimeve – pagave të papaguara, ndërsa pala paditëse ka pretenduar se i takon e drejta në paga dhe në kompensim, dhe se nuk ka parashkrim në këtë rast konkret.

Shkalla e parë kishte konstatuar se objekt i shqyrtimit ishte kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 2009-2013, dhe prapësimi i parashkrimit, i paraqitur nga e paditura. Pas shqyrtimit të dosjes së lëndës kishte konstatuar se kërkesa e paditësit është e bazuar, përkitazi me pagat që i takojnë periudhës Maj 2010 - Maj 2013, ndërsa e njëjta nuk ka bazë ligjore për pagat e tjera të kërkuara, për shkak të parashkrimit të kërkesës. Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Ndërmarrje i datës 30.05.2013, e ka ndërprerë parashkrimin për tri vitet paraprake, respektivisht për pagat që i takojnë periudhës nga muaji Maj i vitit 2010, e tutje. Ndërsa pagat e mëhershme e kanë arritur afatin tre vjeçar të parashkrimit, para se të jepej njoftimi nga pala e paditur. Gjykata ka ardhur tek ky konstatim, në mbështetje të nenit 368, *paragrafi 1 te LMD-së, ku është e përcaktuar se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin*. Pra, në rastin konkret gjykata ka ardhur në përfundimin se letër pezullimi i datës 30.05.2013, ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit. Prandaj, Shkalla e parë ka konstatuar se nuk janë parashkruar detyrimet e të paditurës përkitazi me pagat e mbetura të papaguara të periudhës Maj 2010 – Maj 2013, ndërsa pagat e kërkuara që i përkasin periudhës para muajit Maj të vitit 2010, janë të parashkruara dhe si

të tilla nuk mund të jenë objekt i mbrojtjes gjyqësore. Rrjedhimisht gjykata ka vendosur si në paragrafin I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën e vonesës është i bazuar në neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *"Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore"*.

Me 14 mars 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së ,C-IV-14-1445, të datës 20 shkurt 2023, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit, dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Për më tepër në ankesë, AKP-ja ka pohuar se Gjykata e shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Pjesa shumes prej 1,972.25 euro është refuzuara si e pavlefshme. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizoj në Gjykatë e që është afati i aplikueshëm i parashkrimit bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të drejtën të parashtrij kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. Tutje AKP-ja e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar. Në ankesë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e shkallës së I-rë dhe të II-të të DHPGJS-së.

Më 13 mars 2024, përfaqësuesi i paditëses ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së AKP-së me të cilën ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, të vërtetohet aktgjykimi i atakuar dhe të detyrohet e

paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së odës së Avokatëve të Kosovës, për hartimin e përgjigjes në ankesën e AKP-së ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë në shumë prej 208 euro, sipas nr. tarifor 9. Ankuesi në përgjigjen e parashtruar ka shtuar se e kundërshton në tersi deklaratimet e të paditurës sa i përketë afatit të dytë i cili ndërlidhet me parashkrimin e kërkesës pasi që gjykata e la konfirmuar se kërkesa e ankuesit ishte pjesërisht e parashtruar dhe mbi këtë bazë i ka njohur borxhin e të paditurës për paditësin. Përfaqësuesi i ankuesit pajtohet me interpretimin e gjykatës për mënyrën e vendosjes së kërkesës te ankuesit është parashkruar pjesërisht. Pretendimet e AKP-së se kërkesa nuk është dorëzuar në ndonjë Gjykatë në afat prej 3 viteve duke u bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar janë të pa bazuar sepse ky Ligj nuk është i zbatueshëm në këtë rast pasi që kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm.(lex specialis) përveç tjerash edhe sikur Ligjin mbi Punën e bashkuar të mos ishte shfuqizuar në vitin 1990 ai përfundimisht është hequr nga fuqia që nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës (03L/-212 i botuar në GZ të Republikës së Kosovës më 01.12.2010).

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditurës është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është plotësisht i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 21 tetor 2013, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Barnatoret e Prishtinës"(në likuidim), një kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën tetor 2009- maj 2013, në shumën prej 8,969.45 euro, mirëpo nga AL ishte aprovuar pjesërisht kërkesa për kompensimin pagave në shumë prej 7,347.06 euro, per periudhën tetor 2010-shkurt 2013 nga N.SH "Barnatoret e Prishtinës" (në likuidim). Pjesa tjetër në shume prej 1,029.00 euro, ishte refuzuara per shkak se paditësit kjo shume ishte njohur me vendimin e AL PRN068-0038 në emër të tri pagave të papaguara për periudhën mars –maj 2013, ndërsa pjesa tjetër për pagat e papaguara për periudhën tetor 2009-tetor 2010, në shumë prej 943.25 euro ishte refuzuara si e përshkruara konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Kundër këtij vendim paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJS.

Me 20 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1445, e ka aprovuar pjesërisht si bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka ndryshuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit, me shenjën PRN068-0036, të dt.25.06.2015, dhe e ka detyruar te paditurën që t'ia paguaj paditësit shumën prej 8,686.08 €, në emër të kompensimit të pagave të papaguar për periudhën Maj 2010 – Maj 2013 (36 paga), si dhe shumën prej 868.00 €, në emër të kamatës së vonesës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë, në shumën totale për pagesë prej 9,554.08 €, e cila shumë duhet të shpërndahet tek paditësi në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve. Në piken II është refuzuar pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara, respektivisht mbi shumën e aprovuar me këtë aktgjykim. Ne piken III paditësit shkalla e para i ka njohur shpenzimet e përfaqësimit në shumën prej 124.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura ka parashtruar ankesë për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit, dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit vëren se me Vendimin e AL PRN068-0038 të dt. 25 qershor 2015, paditësit i janë njohur 3 paga të papaguara për periudhën mars-maj 2013 dhe se

për këtë arsye AL me vendimin nr. PRN068-0036 të dt. 25 qershor 2015 i kishte refuzuara kërkesën e paditësit për këtë periudhe. Këtë gjendje faktike shkalla e parë nuk e kishte vërtetuar saktë, pasi që paditësit me aktgjykimin e ankimuar i kishte njohur edhe pagat e papaguara për periudhën mars-maj 2013 edhe pse në fakt një kërkesë e atillë tani me ishte e njohur nga AL. Andaj për këtë arsye aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet, paditësit ti njihet pjesërisht kompensimi vetëm për pagat e papaguar për periudhën maj 2010 – shkurt 2013 (34 paga x 241.28 €), në shumën totale prej 8,203.52 euro si dhe shumën prej 820.35 euro, në emër të interesit ligjor prej 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore, bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa kërkesa e paditësit për periudhën mars –maja 2013, duhet të refuzohet si e pabazuar, për shkak se kjo kërkesë për këto 3 paga, paditësit i është njohur me vendimin e AL PRN068-0038 të dt. 25 qershor 2015.

Kolegji i Apelit e konsideron si të saktë konstatimin e shkallës së parë se me njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i dt. 30 maj 2013 e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës për 3 vitet paraprake, respektivisht për pagat që i takojnë paditësit për periudhën nga muaji maj i vitit 2010 e tutje, ndërsa pagat e mëhershëm pra nga tetori 2009 deri në prill 2010 e kanë arritur afatin 3 vjeçar të parashkrimit, para se të jepej njoftimi nga pala e paditur, andaj për këtë arsye pretendimi i të paditurës i paraqitur në ankesë së kërkesa e paditësit si e tëra është përshkruar është e pabazuar.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 8,203.52 euro (34 paga x 241.28 €), Kolegji i Apelit është bazuara në lartësinë e pagës mujore prej 241.28 €, të cilën vet e paditura i ka njohur paditësit si pagë mujore me vendimin e saj të AL PRN068-0036 dhe se kjo lartësi i e pagës mujore nuk është kontestuar as nga AKP.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar, Aktgjykimi i ankimuar C-IV-15-1445 i dt. 20 shkurt 2023 pjesërisht ndryshohet vetëm përkritazi me pikën I dhe II të dispozitivit, ndërsa vërtetohet pika III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 02 maj 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 08 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
